

# "PRISHTINA ENERGJETIKE"



## Projekti "Çamëria 3"

"Çamëria 3" është projekt në kuadër të megaprojektit investiv në rajonin e Prishtinës.

Plani investues i KEDS në Prishtinë përfshin rritjen e kapaciteteve të linjave ekzistuese nga 10 kV në 20 kV, krijimin e linjave alternative, futjen nën tokë të 90% të rrjetit të tensionit të mesëm, zëvendësimin e 50% të linjave të tensionit të ulët. Nga këto investime do të përfitojnë direkt 90 mijë konsumatorë.

**Të dhëna specifike për projektin:** Ndërrimi i transformatorit , demolimi i 56 shtyllave, vendosja e 2.2 km kablove të reja të tensionit të mesëm dhe 9.8 km kablo të reja të tensionit të ulët, si dhe hapja e kanaleve.

**Përfitues nga projekti "Çamëria 3":** 280 konsumatorë

**Lokacionet kryesore ku do të punohet:** Rr. Haxhi Zeka, Rr. Abedin Rexha, Rr. Fuad Dibra dhe Rr. Lidhja e Prizrenit.

**Periudha e zhvillimit të projektit:** 2020 – 2021

**Përfundimi i projektit:** Korrik 2021

Gjatë zhvillimit të punimeve konsumatorët do të informohen paraprakisht 24-48 orë përmes uebfaqes, rrjeteve sociale dhe aplikacionit eKesco.

# "PRISHTINA ENERGJETIKE"

